



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*



Legjislatura VI

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 70.1 të Rregullores së Kuvendit dhe të neneve 10.1, 10.5, 11 dhe 13 të Ligjit nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në seancën plenare të mbajtur më 17 prill 2018, me propozim të Komisionit Ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, me votim të fshehët, mori këtë:

V E N D I M

1. Znj. Violeta Hyseni-Kelmendi zgjedhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, me mandat katër (4) vjeçar.
2. Znj. Maja Slavić zgjedhet anëtare e Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit serb, me mandat tre (3) vjeçar.
3. Kandidatët e propozuar Birol Urcan dhe Mejdin Saliji, për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radha e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, asnjëri nuk i morën votat e nevojshme për tu zgjedhur anëtar i këtij Komisioni. Duhet të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një anëtari nga radha e komuniteteve tjera joshumicë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 06-V- 121

Prishtinë, 17.04.2018

Kryetari i Kuvendit  
  
Kadri VESELI

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të Pavarur të Mediave,
- Arkivit të Kuvendit.